

URDHËR
Nr. 377, datë 28.7.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për datat 31.7.2026–16.8.2026 te zëvendësministri i Drejtësisë, z. Tedi Dobi.
 2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Tedi Dobi, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Toni Gogu